



Në bazë të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016, të datës 12.01.2016, Gjimnazi " JETA E RE" në Suharekë bën:

## FTESË PËR OFERTË – Nr. 01/2025

### Për ekskursionin e maurantëve të Gjimnazit "JETA E RE" në Suharekë

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë prej datës 05 deri më 09 Maj 2025.

Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) bujtje ku përfshihen: mëngjesi, dreka dhe darka.

Në ekskursion do të marrin pjesë 233 nxënës.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit, transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe ambiente të tjera kulturore-historike që parashihen në rrugëtimin e ekskursionit.

Operatorët Ekonomik - që konkurrojnë duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. OE duhet të ketë licencën D me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit, ofertës t'i bashkëngjitet fotokopja e licencës (e vërtetuar te Noteri).
2. OE duhet të ketë Certifikatën e regjistrimit, ofertës t'i bashkëngjitet fotokopja e certifikatës (e vërtetuar te Noteri).
3. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore, ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion.
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit.
5. Për tërë personat e angazhuar në ekskursion nga OE (shofer dhe konduktor) duhet të paraqiten certifikatat e mjekut.
6. OE duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij, ofertës t'i bashkëngjiten: Certifikata e punës, diploma dhe marrëveshja me mjekun, për kohëzgjatjen e ekskursionit.
7. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanojë shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
8. Të ofrojë dëshmi për rezervimin e hapësirave hoteliere në Durrës, si dhe licencën e akreditimit të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
9. Afati i konkurrimit 7 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
10. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
11. Formulari i Paraqitjes së Ofertës dhe Rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli drejtues i shkollës merren në Gjimnazin "JETA E RE" në Suharekë nga data 06.03.2025.
12. Dorëzimi i ofertave bëhet deri më 14.03.2025 në ora 14.00, në zyrën pritëse të Qendrës për shërbime qytetare të Komunës së Suharekës – për DKA – Gjimnazi "JETA E RE" Suharekë.
13. Hapja e ofertave bëhet me datë 14.03.2025 në ora 15.00 në DKA në Suharekë.
14. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Suharekë, më 06.03.2025



Drejtori: Fadil Elshani, prof.